



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 65**

**Prishtinë, më 13.02.2017 në orën 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Çeku, Mufeta Shiniq, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

**Munguan:** Jasmina Zhivković, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq dhe Slavko Simiq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** përfaqësues nga OSBE-ja, Saniqe Berisha; përfaqësuese nga Ambasada Zvicrane, Hajrudin Skenderi; përfaqësues nga BIRN ( Rrjeti Ballkanik për gazetari hulumtuese) Rahman Ramaj; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit me datë: 15.12.2016 dhe 23.01.2017;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-130 për Shërbime me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike me amendamente të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e arëmve dhe dorëzimin e arëmve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës;**
6. **Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më: 15.12.2016 dhe 23.01.2017.**

**Nënkryetari**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 15.12.2016 dhe 23.01.2017, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-130 për Shërbime me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-130 për Shërbime dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim apo sygjërim në raport me amendamente të Komisionit Funksional.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-130 për Shërbime dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike me amendamente të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sygjërim në raport me amendamente të Komisionit Funksional.

*Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e arëmve dhe dorëzimin e arëmve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e arëmve dhe dorëzimin e arëmve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-134 për legalizimin e arëmve dhe dorëzimin e arëmve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**6. Të ndryshme.**

**Nënkryetari**, pasi anëtarët e Komisionit nuk paraqitën për shqyrtim temë shtesë, ai konstatoi mbledhjen e mbyllur.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:30.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit.**

**Nënkryetar i Komisionit,**

---

**Agim Çeku**